



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik
Municipality of Kačanik
01Nr.16-8831/14
Kačanik, 31.03.2014



Në mbështetje të nenit 17 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe në bazë të Udhëzimit Administrativ Nr. 27/2012 MPB – 03/2012 MAPL Për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi, Kuvendi i Komunës Kačanik, në mbledhjen e vet të mbajtur me datë 31.03.2014, mori këtë:

V E N D I M

Për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi

I.

Me këtë Vendim, themelohet Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) në komunën e Kaçanikut.

II.

Përbërja e KKSB është:

1. Kryetari i Komunës - kryesues,
2. Komandanti i Stacionit Policor në Kačanik,
3. Përfaqësuesi i Këshillit të Bashkësisë Islame në Kačanik,
4. Përfaqësuesi nga komunitetet etnik pakicë në komunë,
5. Kryesuesi i Komitetit për Kominitete,
6. Zyrtari për Barazi Gjinore,
7. Drejtori i Drejtorisë për Arsim,
8. Kryetari i Këshillit të Prindërve të Arsimit,
9. Përfaqësuesi i FSK-së,
10. Përfaqësuesi i Këshillit Lokal për Siguri Publike,
11. Kryesuesi i Ekipit Veprues Komunal për Siguri në Bashkësi,
12. Përfaqësuesi nga Sektori Emergjencave Civile Komunale,
13. Përfaqësuesi i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim,
14. Përfaqësuesi i OJQ-ve lokale,
15. Përfaqësuesi i mediave lokale,
16. Përfaqësuesi i bizneseve lokale,
17. Përfaqësuesi nga komuniteti lokal i personave me aftësi të kufizuar.

III.

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi është përgjegjës për veprimet dhe detyrat e përcaktuara sipas Udhëzimit Administrativ Nr. 27/2012 MPB – 03/2012 MAPL Për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi.

IV.

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës.

V.

Për zbatimin e këtij vendimi do të përkujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë dhe Anëtarët e KKS-së.

Me këtë Vendim do të njoftohen:

1. Kryetari i Komunës – përmes Zyrës së Kryetarit njoftohen anëtarët e KKS-së,
2. Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë,
3. Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim, dhe
4. Arkiva.



Kryesuesi i Kuvendit,
Xhelal Gashi